



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.44/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziq dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterit në hapsira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kështu që koalicionit LDK-AKR, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,400.00 (njëmijë e katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datë 03.06.2017, rreth orës 13:00 nga qendra përkatësisht në sheshin “Nënë Tereza” në Prishtinë, aktivistja Arbëri Krasniqi ka vërejtur se ishte vendosur postieri i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Dardan Velija me nr.85 nga radhët e koalicionit LDK-AKR. Parashtruesi i ankesës potencon se në kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të KQZ-së, nenit 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Prandaj sipas këtyre veprimeve koalicioni LDK-AKR, kanë bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr. 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.06.2017, koalicioni LDK-AKR thekson se lidhur me pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe urdhëresës së PZAP-it për të ndërmarrë masa përmirësuese, kanë urdhëruar kandidatin që të ndërmarrë veprime përmirësuese, pasi që nga fotoja e dëshmuar shihet se kandidati ka qenë duke zhvilluar një bisedë me qytetarët dhe pas përfundimit të bisedës posteri i kandidatit në fjalë është larguar dhe nga ky veprim është evituar shkelja e pretenduar në ankesë. Për më tepër ka theksuar,

fotoja nuk është e ngjitur, por është thjeshtë një baner që ka shërbyer për ti njoftuar qytetarët për bashkëbisedim. PZAP-it, i kanë kërkuar që mos ti shqiptoj gjobë pasi që kanë konsideruar se nuk ka pasur shkelje ligjore .

Në cilësinë e provës, përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur një foto përmes së cilës nuk dëshmohet veprimi i ndërmarrjes së masave përmirësuese të pretenduara sipas përgjigjes në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Dardan Velija me nr.85 nga radhët e koalicioni LDK-AKR është vendosur në hapësirat publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterit i kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR është vendosur në hapsirë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe faktin për kundër të këtij fakti posterit i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në hapsirë publike. Po ashtu si rrethanë, Pzap-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.44/2017 më datën 06.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



**Këshilla Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.